

Mbështetja e Njerëzve Kush jemi ne dhe çfarë bëjmë.

Çfarë është Mbështetja e Njerëzve?

Çdo ditë ka shumë njerëz në komunitet që kanë nevojë për ndihmë. Ndoshta duan të gjejnë punë, por nuk dinë mënyrën më të mirë për ta bërë këtë. Apo ndoshta nuk e paguajnë dot qiranë dhe merakosen se mos do të ju duhet ta lënë shtëpinë e tyre.

Këshilli i Haringejit bashkë me njerëz tjerë, është i gatshëm për t'ju ndihmuar me këto probleme dhe të tjera që mund të keni. Ndhmuesit tjerë janë nga Trusti i Mësimi të Kujdesit Primar i Shërbimit Kombëtar Shëndetësor Haringej (Haringey NHS Teaching Primary Care Trust) dhe Shërbimet e Lirimit me Kusht të Londrës (London Probation Services).

Emri i kësaj ndihme është Mbështetja e Njerëzve. Nëse keni një problem apo njihini dikë që ka probleme, lexoni më tej për të parë çfarë ofrojmë ne.

Me çfarë mund të ndihmojë Mbështetja për Njerëz?

Ne mund të ndihmojmë me këto sfida jetësore:

- Doni të gjeni një vend për të jetuar dhe për të krijuar shtëpinë tuaj.
- Ndoshta merakoseni se nuk keni paguar qiranë tuaj. Keni merak që mos ju duhet ta lini shtëpinë tuaj.
- Doni të kujdeseni për veten dhe të mos keni nevojë të kërkonit ndihmë nga shokët dhe familja. Ju doni të mësoni se si ta bëni këtë.
- Ndoshta ju duhen më shumë ndihma financiare dhe nuk e dini si t'i kërkonit këto.
- Ndoshta jetoni vetëm. Do të donit që dikush t'ju vizitonte për të parë që jeni të sigurt dhe mirë me shëndet.
- Jeni të etur të gjeni punë. Ju e dini që ju duhet trajnim dhe ndihmë për të gjetur punë.
- Ndoshta nuk ndjeheni të sigurt në shtëpinë tuaj dhe doni një alarm për të kërkuar ndihmë kur të keni nevojë.

Çfarë njerëzish ne ndihmojmë?

Nëse ju, një shok apo i afërm ka cilindo nga këto probleme, këshilli është i gatshëm t'ju ndihmojë.

- Nëse nuk keni asnjë vend ku të jetoni.
- Nëse o jetoni me nevoja të shëndetit mendor.
- Nëse jeni një person i vjetër që ka nevojë për ndihmë.
- Keni nevojë për ndihmë për të mësuar gjëra të reja.
- Ju apo një shok apo i afërm ka HIV/SIDA.
- Nëse jeni një i ri pa familje për t'ju drejtuar, apo jeni duke lënë vendin ku keni qenë nën kujdes.
- Njerëzit që kanë bërë gjëra që janë kundër ligjit janë apo akoma vazhdojnë të bëjnë gjëra kundër ligjit.

- Ndoshta dikush në familjen tuaj ju ka trajtuar keq duke ju goditur apo ju ka kërcënuar që t'ju lëndoje.
- Ndoshta komshinjtë tuaj kanë përdorur fjalë urrejtjeje apo kërcënuese ndaj jush.
- Problemi juaj mund të jetë që përdorni drogë apo pini shumë alkool.
- Keni lënë shtetin tuaj dhe doni një jetë më të mirë këtu.
- Prindërit adoleshentë shpesh kanë nevojë për ndihmë.
- Ndoshta keni problem në ecje, bërjen e punëve në shtëpinë tuaj apo jeni në karrocë invalidësh.
- Ndoshta nuk dëgjoni apo shikoni mirë.

Cilat shërbime japin këtë ndihmë?

Janë dy lloje ndihmash:

Shërbimet mbështetëse pluskuese

I pari quhet mbështetja pluskuese. Është në dispozicion për njerëzit kudo që jetojnë, për njerëzit që jetojnë më vete. Ata gjithashtu mund të kenë me qira pronë këshilli apo mund të jetojnë në pronë të Shoqatës së Strehimit apo të marrë me qira privatisht. Apo njerëz që pronësojnë shtëpitë e tyre.

Mbështetja pluskuese është falas. Ju mund t'i qaseni kësaj vetë apo me ndihmën e dikujt. Nëse keni nevojë për këtë, merrni numrat në vijim:

Për familje:

HARTS

☎: 0845 303 2350

Për njerëz mbi 60 vjeç:

Sixty Plus

☎: 0800 652 6100

Për njerëzit e moshave 16-59 vjeç beqarë apo çifte pa fëmijë:

Key Support

☎: 020 8347 2327

Ka mbështetje speciale pluskuese për njerëz nga disa komunitete Etnike.

Për të mësuar më shumë mbi këtë kontakto Ekipin e Sektorit Vullnetar të Korporatës në:

The Corporate Voluntary Sector Team

☎: 020 8489 6913

Ekipi Shëndosh e Sigurt i Haringejit (Safe and Sound team) do ju japë një alarm që mund ta përdorni në shtëpinë tuaj për të thirrur për ndihmë nëse keni ndonjë aksident apo nëse jeni viktimë e krimit.

☎: 020 8489 2365 ose vizito faqen tonë të internetit në www.haringey.gov.uk

Kujdesi dhe Riparimi Metropolitan (Metropolitan Care and Repair), të cilën ne e financojmë, është i gatshëm për t'ju ndihmuar gjithashtu. A keni nevojë për ndonjë ndreqje në shtëpi? Ndoshta ju duhet ndihmë me punë në kopsht. Nëse keni paaftësi mund t'ju duhen ndryshime në shtëpinë tuaj. Ata gjithashtu do t'ju tregojnë se si të mbroheni nga krimet.

☎: 020 8829 8310

Shërbimet e bazuara në banesa.

Ndihma tjetër që ju mund të merrni quhet shërbime të bazuara në banesa. Kjo do të thotë që ndihma jepet në vendin ku jetoni. Disa nga këto shërbime ju ofrojnë ndihmë 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Ndihma mund të përfshijë:

- strehim me mbrojtje për pleq
- bujtina me përkrahje për të pastrehë, për kundërvajtës (njerëz që kanë bërë diçka të kundërligjshme) dhe për njerëz që po përmirësohen nga marrja e drogërave apo nga pirja e tepërt e alkoolit
- strehë (shtëpi të sigurta) për njerëz që janë trajtuar keq (goditur) nga dikush në familjen e tyre
- strehim me përkrahje për njerëz që jetojnë me nevoja të shëndetit mendor
- strehim me përkrahje për njerëzit me paaftësi mësimore
- strehim me përkrahje për njerëzit që jetojnë me paaftësi mendore apo fizike. Ndoshta është e vështirë lëvizja andej këndeje dhe rregullimi i gjërave.
- strehimi me përkrahje për njerëz që kanë dëmtime dëgjimi apo vizuale
- banesa trajnimi me përkrahje për të rinj që zhvendosen nga një vend ku kanë qenë nën kujdes dhe tjerë të rinj që nuk kanë ku të drejtohen.

Ju nuk mund t'i qaseni këtyre shërbimeve vetë. Personi që është përgjegjës për kujdesin tuaj, apo që ju ndihmon do t'ju referojë. Ky mund të jetë punonjës social, këshilltar shëndeti mendor apo mjek për shembull. Për të mësuar më shumë mbi këto shërbime, na kontaktoni në:

📍: Supporting People Team, 40 Cumberland Road, N22 7SG

☎: 020 8489-3344

@: supporting.people@haringey.gov.uk

Mbështetja e Njerëzve nuk jep disa shërbime

Ne nuk mund t'ju ndihmojmë me:

- kujdes personal apo ndihmë me pastrimin e rrobave apo të veshjes/zhveshjes
- përgatitjen e shujtave, pazarin apo gatimin përditë
- kujdesin e fëmijëve
- kujdesin shëndetësor
- këshillim specialisti (të folurit me dikë mbi problemet).

Megjithatë, nëse doni të dini më shumë se si Shërbime e Socialit të Këshillit të Haringejit mund t'ju ndihmojnë, kontaktoni:

Social Services

☎: 020 8489-0000

A më duhet të paguajë për ndihmë, dhe si të ankojem?

Nëse merrni ndihmë për më pak se 2 vjet, ndihma është falas. Nëse merrni ndihmë për një kohë të gjatë (më shumë se dy vjet) juve mund t'ju duhet të paguani.

Nëse merrni Ndhimja Strehimi shërbimet janë falas.

Kur të aplikoni për ndihmë, juve do t'ju thuhet nëse ju duhet të paguani. Është një fletushkë tjetër me të dhëna se si të aplikoni për shërbime falas apo zbritje në çmim të tyre të quajtur "Si paguhet shërbimi im i Mbështetjes së Njerëzve" ("How is my Supporting People service paid for"). Ju lutem na kontaktoni për një kopje të kësaj.

Nëse nuk jeni të kënaqur me shërbimin e Mbështetjes së Njerëzve, tregoni punonjësit tuaj të mbështetjes apo menaxherit të shërbimit. Nëse nuk jeni të kënaqur me rezultatin kontaktoni Ekipin e Mbështetjes së Njerëzve. Ekziston gjithashtu fletushka me më shumë hollësi se si të mos pajtoheni me një vendim apo si të ankoheni mbi ndonjë shërbim. Ju lutem na kontaktoni për një kopje të kësaj.

Për të mësuar më shumë mbi këtë apo nëse keni ndonjë problem tjetër, ju mund të na kontaktoni.